



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 104/02-34950/19
Kaçanik, 31.10.2019

Mbështetur në nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 59 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 3588.2008 të datës 25.09.2019, me Ftesën e Kryetarit të Bashkisë së Beratit të Republikës së Shqipërisë Nr.5363 të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 Tetor 2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR REALIZIMIN E NJË UDHËTIMI ZYRTARË TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK, NË BASHKINË E BERATIT DHE TË DISA BASHKIVE TJERA TË JUGUT TË SHQIPËRISË

1. Me këtë Vendim, vendoset të realizohet një vizitë zyrtare e Kuvendit të Komunës Kaçanik, në Bashkinë e Beratit dhe disa Bashkive tjera në pjesën e Jugut të Shqipërisë, prej datës, 21-24 Nëntor 2019.
2. Vizita zyrtare nga pika 1. e këtij vendimi, realizohet në bazë të Ftesës së Kryetarit të Bashkisë së Beratit, Ervin Demo, Nr.5363 të datës 31 Tetor 2019, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të Bashkisë së Beratit dhe Komunës së Kaçanikut.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Ftesa Nr.5363 e Bashkisë së Beratit e datës 31.10.2019 dhe Agjenda e Grupit Punues të KK.
4. Përgatitjet e nevojshme për realizimin e vizitës do të kujdesen, Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Shefat e GP të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.
5. Shpenzimet për realizimin e vizitës nga pika 1 e këtij vendimi do t'i bartë Komuna e Kaçaniku, ndërkaq do të kujdeset t'i zbatoj, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për Procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Kryesuesi i Kuvendit;
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT

Nr. 5363 Prot

Berat, 31.10. 2019

Lënda: Ftesë për vizitë zyrtare në Bashkinë e Beratit.

Drejtuar: **Z. Kemajl MURSELI**
KRYETARI I KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK			
Data	31.10/19	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01 Nr.104	102-34950/19		

I nderuar Z. Murseli- Kryetar i Kuvendit ,

Gjej rastin t'Ju dërgoj përshëndetje të përzemërta në adresën Tuaj .

Më lejoni nëpërmjet kësaj Ftese, t'Ju ftoj Ju dhe Këshilltarët e Komunës Kaçanik për një vizitë zyrtare në Bashkinë Berat në datën 22 Nëntor 2019.

Gjatë vizitës zyrtare, do të kemi mundësinë të shkëmbejmë përvojat dhe të rrisim bashkëpunimin ndërmjet dy Bashkive tona.

Do të ishte nder dhe kënaqësi të prisja në Berat Delegacionin e Komunës Kaçanik dhe Ju personalisht, ku do të njiheni edhe me zhvillimet dhe projektet më të fundit në Bashkinë Berat.

Duke pritur t'Ju takoj në Berat, ju faleminderit për vëmendjen.

Me respekt ,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

Nisja	Arritja	km dhe koha e udhtimit	aktivitetet
Datë 21.11.2019			
Kaçanik ora 8	Elbasan ora 13	340 km për 5 ore	Dreka në Elbasan , takim me struktura nga Elbasani , vizite qytetit deri ora 16
Elbasan ora 16	Berat ora 17:30	1ore e gjysme 72 km	Akomodim + Darkë + mëngjes në Hotel Berat
Datë 22.11.2019			
Mëngjesi berat	Agjenda me takime		Ora 14 Dreka në qytetin e Beratit. Vizitë qytetit deri ora 16:30
Berati ora 17	Vlorë ora 19	85 km për 2 orë	Akomodim + Darkë + mëngjes Vizitë Muzeut të Pavarisë Vlorë.
Datë 23.11.2019			
Vlorë ora 9	Tepelenë ora 10:30	100 km për 1 orë e 30min	Ora 11 Vizitë Bashkisë Tepelenës . ora 12:
Tepelenë ora 12	Gjirokastrë ora 13	32 km per 1 ore	Dreka . Vizitë qytetit të Gjirokastrës deri ora 17
Gjirokastrë ora 17	Sarandë ora 18:30	56 km Për 1 ore 30 min	Akomodim +darkë + mëngjes
Datë 24.11.2019			
Sarandë ora 8:30	Butrint ora 9:10	18 km për 40 min	Vizite qytetit te Butrintit deri ora 11
Butrint ora 11	Ksamil ora 11:15	5 km për 15 min	Vizita në Ksamil deri ora 12 : 30
Ksamil ora 12:30	Sarandë ora 13	14 km për 30 min	Dreka në Sarandë deri ora 14
Sarandë ora 14 : 15	Syri I Kaltër ora 14:45	20 km per 30 min	Vizit syri kalter deri ora 15:30
Syri I Kaltër ora 15:30	Divjakë ora 18 : 30	200 km per 3 orë	Darka në Divjakë
Divjakë 19 : 30	Kaçanik ora 24	310 km per 4 ore e 30 min	

Grupi Punues në Hartimin e Agjendes :

Nexhat Loku PDK

Ekrem Kyqyku VV

Selim Reka LDK

Bekim Coxha NISMA

Shemsedin Luzha I Pavarur

Kryesuesi I Kuvendit : Kemajl Murseli